



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**BASHKIA SHKODËR**  
**DREJTORIA E PLANIFIKIMIT STRATEGJIK DHE PËRMIRËSIMIT TË**  
**KLIMËS SË BIZNESIT**

---

Nr. \_\_\_\_\_ Prot

Shkodër, më \_\_\_\_\_.\_\_\_\_\_.2020

**Lënda:           Përgjigje kërkesë për informacion**

\_\_\_\_\_  
\_\_\_\_\_, Durrës  
**e.mail:** \_\_\_\_\_

Në përgjigje të kërkesës tuaj numër 216 dt. 27.05.2020, drejtuar Bashkisë Shkodër me anë të portalit pyetshtetin.al dhe regjistruar me nr.7565 prot., datë 03.06.2020, në të cilën bazuar në ligjin nr.119/2014, “Për të Drejten e Informimit” kërkonti informacion, ju bëjmë me dije se:

Planet strategjike të Bashkisë Shkodër, janë të publikuara në faqen e saj të internetit, në linkun [http://www.bashkiashkoder.gov.al/web/Plani\\_i\\_pergjithshem\\_vendor\\_1420\\_1.php](http://www.bashkiashkoder.gov.al/web/Plani_i_pergjithshem_vendor_1420_1.php).

Në Bashkinë Shkodër kemi tregje publike dhe tregje private në të cilat tregtarët ushtrojnë aktivitetin e tyre tregtar. Sipas nevojës së analizuar në territor Bashkia Shkodër, ka bërë ndërhyrjet e saj me investime për përmirësimin e kushteve të këtyre tregjeve. Kështu është investuar në tregun e Rusit (treg ambulant për produktet bujqësore) gjithashtu është punuar për sa i përket tregjeve të lëvizshme në lagje të ndryshme të qytetit Shkodër. Gjithashtu është krijuar edhe tregu ambulant në Velipojë për sezonin veror. Siç do të vëreni edhe në Planin Strategjik, Bashkia Shkodër ka të parashikuar ndërtimin e tregut të peshkimit, tregut të produkteve Bio dhe zgjerimit të tregut rajonal ekzistues në Shkodër.

Bashkia Shkodër në kuadër të promovimit të bizneseve vendase dhe produktit lokal organizon panairë të përvitshme. Panairët organizohen në njësitë administrative Shkodër si dhe në qytetin e Shkodërs për të promovuar dhe reklamuar produktet lokale. Çdo vit, organizohet dhe panairi i punës në bashkëpunim me bizneset, universitetin dhe zyrën e punës. [http://www.bashkiashkoder.gov.al/web/Per\\_Biznesin\\_153\\_1.php](http://www.bashkiashkoder.gov.al/web/Per_Biznesin_153_1.php)

Bashkia Shkodër në bashkëpunim me donatorë dhe organizata të ndryshme mbështet dhe organizon aktivitete të ndryshme për dhënie e granteve për bizneset e vogla e të mesme duke nxitur pjesëmarrjen e bizneseve të qytetit në këto thirrje për grante. Grantet dhe asistencë që është dhënë për bizneset ka pasur impakt në fusha të ndryshme që nga

zhvillimi i bizneseve që veprojnë në fushën e agro-turizmit, bizneset e vogla inovative (start-up) si dhe grantet dhe mbështetja për sektorin bujqësor.

Broshurat informative mund ti gjeni në

[http://www.bashkiashkoder.gov.al/web/Lidhjet\\_265\\_1.php](http://www.bashkiashkoder.gov.al/web/Lidhjet_265_1.php)

[http://www.bashkiashkoder.gov.al/web/profili\\_i\\_bashkise\\_2703.pdf](http://www.bashkiashkoder.gov.al/web/profili_i_bashkise_2703.pdf)

Bashkia Shkodër publikon materialet dhe informacionet e biznesit duke paraqitur prioritetet, taksat, rregullat dhe procedurat që duhen ndjekur për hapjen dhe zhvillimin e bizneseve.

[http://www.bashkiashkoder.gov.al/web/Per\\_Biznesin\\_153\\_1.php](http://www.bashkiashkoder.gov.al/web/Per_Biznesin_153_1.php)

Mbetemi të hapur për çdo bashkëpunim me ju.

**KRYETAR**

**Voltana Ademi**